

# Aftësimi për Tregun e Punës – Fit for Jobs

## Rritja e mundësive të punësimit për të gjithë të rinjtë në Kosovë

### Objektivi dhe qasja

Në emër të Qeverisë Gjermane, projekti i GIZ-it «Aftësimi për Tregun e Punës» synon rritjen e punësimit të të rinjve përmes përmirësimit të orientimit në karrierë, përfshirjes së shtuar të sektorit privat në arsimin dhe aftësimin profesional (AAP), dhe në përgjithësi orientimin më të fortë në tregun e punës të arsimit. GIZ ndihmon Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) për të përkrahur përfshirjen sistematike të orientimit në karrierë, si dhe orientimin në tregun e punës të aftësimit profesional në politikat dhe strategjitë përkatëse të reformës. Institucionet publike, sektori privat, shkollat partnere dhe shkollat profesionale, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe shoqëria civile mbështeten për të kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e punësimit të të rinjve kosovarë.

Në qershor të vitit 2021 është lansuar moduli i ri i projektit. Ai mbulon katër fushat e ndërhyrjes, duke përfshirë: a) Prezantimin e **orientimit në karrierë** në mënyrë sistematike në sistemin arsimor të nivelit të shkollës së mesme; b) Promovimin e **përfshirjes sistematike të sektorit privat** në AAP; c) Përmirësimin e **kalimit nga arsimi profesional ose papunësia në tregun e punës** duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të tregut të punës për të rinjtë dhe grupet e cenueshme, përfshirë të kthyerit; dhe d) **Përfshirjen e orientimit në tregun e punës të arsimit profesional** si dhe orientimit në karrierë në politikat dhe strategjitë përkatëse të reformës.

### Rezultatet e Projektit

Me qasjen e vet sistematike dhe **tri-nivelesh**, projekti:

- ✓ kontribuon në rritjen e kapaciteteve të personelit të shkollës për të forcuar pjekurinë e punësimit dhe aftësimin të të rinjve, për të futur në zbatim instrumente të orientimit profesional në shkolla dhe për të zgjeruar

qasjen e planifikimit të zhvillimit të integruar të shkollave;

- ✓ përkrah përfshirjen e sektorit privat për të përmirësuar cilësinë e AAP-së dhe forcon rolin dhe funksionalitetin e odave dhe shoqatave sektoriale;
- ✓ kontribuon në efektivitetin më të madh të institucioneve të tregut të punës për të orientuar shërbimet aktive të tregut të punës drejt nevojave të të rinjve dhe grupeve të cenueshme, përfshirë të kthyerit; kontribuon në forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike për zhvillimin e strategjive, ligjeve dhe rregulloreve kombëtare duke përfshirë orientimet në karrierë dhe orientimin e tregut të punës të arsimit profesional në politikat dhe strategjitë përkatëse të reformës.

Emri i projektit	Aftësimi për tregun e punës
Angazhuar nga	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)
Vendi i zbatimit	Republika e Kosovës
Agjencia zbatuese	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Kohëzgjatja	06/2021 – 05/2024
Partnerët kryesor politikë	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)  Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)
Komunat e zbatimit	Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Prizren, Vushtrri, Skënderaj, Glogoc, Lipjan, Suharekë, Deçan, Shtime, dhe të tjera.

## Aktivitetet kryesore të projektit

- ✓ Mbështetja e MASHTI-it dhe Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) në prezantimin e qasjes së orientimit në karrierë në shkollat e mesme të ulëta;
- ✓ Prezantimi i instrumenteve të orientimit profesional në shkolla si pjesë e qasjes për planifikim të zhvillimit të integruar të shkollave;
- ✓ Forcimi i kompetencave digjitale në nivel të shkollës (përfshirë mësimdhënësit dhe nxënësit) përmes qasjeve tashmë të krijuara inovative të qëndrueshme;
- ✓ Mbështetja e kualifikimit të mësimdhënësve të shkollave profesionale në teori, praktikë, pedagogji, zbatim të kurrikulës, punë ekipore dhe metoda digjitale të mësimdhënies;
- ✓ Forcimi i rolit të odave dhe shoqatave sektoriale në lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet kompanive dhe shkollave profesionale;
- ✓ Realizimi i një fushate të vetëdijesimit për të përmirësuar imazhin e shkollave profesionale dhe për të krijuar interesimin më të lartë nga kompanitë për të marrë pjesë në programet e të mësuarit në vendin e punës;
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të tregut të punës, të tilla si Agjencia e Punësimit, zyrat komunale të punësimit, ofruesit publik dhe privat të shërbimeve të tregut të punës, në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i tyre;
- ✓ Mbështetja e zbatimit të udhëzimeve për masat aktive të tregut të punës në nivel lokal dhe masave specifike të tregut të punës për të kthyerit dhe grupet e cënueshme;
- ✓ Mbështetja e ministrive partnere (MASHTI dhe MFPT) në përfshirjen e orientimit në karrierë dhe orientimit në tregun e punës të arsimit (profesional) në reformat përkatëse të politikave dhe në strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

## Rezultatet e pritura

- ✓ Të rinjtë, **klasa 9**, janë kompetentë dhe më të zotë në marrjen e vendimeve të mirë informuara për arsimin dhe karrierën e tyre profesionale.
- ✓ Përforcimi i përfshirjes së sektorit privat në AAP, duke ua mundësuar nxënësve të **klasave 10-12** që të kenë më shumë përvojë nga të mësuarit në vendin e punës në kompani dhe, aftësi praktike të nevojshme për të hyrë në tregun e punës;
- ✓ Orientimi i arsimit profesional në tregun e punës është përfshirë më mirë në politikat dhe strategjitë përkatëse, duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në orientimin në karrierë dhe mundësitë e punësimit të të rinjve;
- ✓ Rritja e shërbimeve të tregut aktiv të punës, duke e bërë më efektiv dhe më efikas gjetjen e punës për punëkërkuessit, veçanërisht për të rinjtë, grupet e cënueshme dhe të kthyerit.



Botuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH  
Zyrat e regjistruara në Bonn dhe Eschborn, Gjermani  
Zyra e GIZ-it në Prishtinë  
Trajnimi për tregun e punës – Aftësimi për tregun e punës  
Rr. Gazmend Zajmi 80  
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës  
T +381 38 233 002 100

Udhëheqësi i Projektit Tobias Seiberlich – [tobias.seiberlich@giz.de](mailto:tobias.seiberlich@giz.de)  
[www.facebook.com/gizpristina](https://www.facebook.com/gizpristina)

Në emër të Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Në bashkëpunim me Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Fotot e realizuara nga GIZ Kosovë

GIZ është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi

Data Shtator 2021